

ABSTRAKTI

Zhvillimi, kompleksiteti dhe shtrirja e gjerë e teknologjisë imponon sfida të reja për sistemin ligjor në mbrojtjen e shoqërisë. Derisa shoqëria po përfiton shumë nga interneti, ata gjithashtu po përballen me një lloj të ri të krimit, krimin kibernetik. Duke përdorur kompjuterët për kryerjen e krimeve, përdoruesit e zgjuar të kompjuterit gjatë njëzet vjetëve të fundit kanë shtangur botën.

Hapësira kibernetike në përgjithësi, dhe krimi kibernetik në veçanti, janë dukuri relativisht të reja, dhe me këtë mbizotërim të internetit në jetën e përditshme të njerëzve, çështja e krimit kibernetik duhet të pranohet, adresohet dhe hulumtohet më shumë se kurrë. Krimi kibernetik është rritur në mënyrë progresive me autorë që zhvillojnë teknika më të reja dhe të sofistikuar çdo ditë. Pavarësisht nga masat e marra për të luftuar dhe për të zbutur efektet e tij, krimet kibernetike kanë vazhduar të rriten në mënyrë alarmante në të gjithë botën.

Krimi kibernetik përfshinë aktivitetet kriminale të kryera me anë të kompjuterëve ose internetit dhe shfaqet në forma të ndryshme si: Mashtrimet kibernetike; Phishingu; Hyrja e paautorizuar në sisteme kompjuterike; Ngacmimi kibernetik(cyber-bullying); Terrorizmi kibernetik; Sabotimi kibernetik; Spiunazhi kibernetik; Vjedhja e identitetit; Pornografia kibernetike.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës parasheh disa vepra penale që bien në fushën e krimit kibernetik, poashtu Kuvendi i Republikës së Kosovës ka aprovuar Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik i bazuar në Konventën e Budapestit mbi Krimin Kibernetik, i cili ka për qëllim parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik me masa konkrete, parandalimin, zbulimin dhe sanksionimin e shkeljeve përmes sistemeve kompjuterike, duke ofruar respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Fjalët kyçe: Krimi kibernetik; Sistemi kompjuterik; legjislacioni; krimi i organizuar

